



**Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina**



Drejtoria për Zhvillim Rural

THIRRJE PËR APLIKIM

PËRKRAHJA E FERMERËVE NË PERIMTARI-SERRA 200m²

Tipi i serrës që mbështetet (përkrahet) është:

- Serra e tipit “Tunel”, sipërfaqja prej 200 m²

Kriteret e përgjithshme:

- Aplikuesi duhet të ketë pronën në territorin e Komunës së Prishtinës dhe të jetë banor rezident i saj;
- Fermerët të cilët planifikojnë ngritjen e serrës me sipërfaqe prej 0.02 ha, të tipit “tunel”, parcela duhet të jetë minimum e gjatë 29.00 m dhe minimum e gjerë 12.00 m;
- Fermerët aplikues për serrë 0.02 ha duhet të posedojnë së paku një sipërfaqë prej 0.02 ha të pandarë, të mbjellë me perime;
- Nuk mund të jetë përfitues më shumë se një anëtar i bashkësisë familjare;
- Fermerët të cilët nuk kanë pronën në pronësi familjare, por shfrytëzojnë toka me qira, duhet të kenë marrëveshje të nënshkruar nga palët (të noterizuar), në kohëzgjatje prej pesë (5) vitesh;
- Nuk kanë të drejtë përfitimi fermerët dhe anëtarët e ngushtë të bashkësisë familjare, të cilët kanë përfituar serrë nga komuna dhe donatorët në bashkëpunim me komunën, në tri (3) vitet e fundit.

Kriteret specifike:

- Fermerët me sipërfaqe më të madhe, kanë përparësi në raport me ata që kanë sipërfaqe më të vogël të mbjellë me perime (spec, domate, sallatë të gjelbër, tranguj, karrota, qepë, hudhër);
- Në kushte të barabarta, përparësi përfitimi kanë fermerët dhe anëtarët e ngushtë në bashkësi familjare, të cilët nuk kanë qenë asnjëherë përfitues të serrave nga komuna dhe donatorët në bashkëpunim me komunën;
- Njohuritë elementare në fushën përkatëse;
- Fermerët me përgatitje profesionale shkollore (shkolla e mesme bujqësore, fakulteti përkatës);
- Fermerët të cilët kanë ndjekur trajnime përkatëse;
- Gratë fermere dhe grupet e marginalizuara;
- Prona në pronësi të aplikuesit (fermerit);
- Prona e marrë me qira;
- Infrastruktura përcjellëse (burimi i ujit, sistemi i ujitjes);
- Fermerët banorë rezident në vendin ku planifikohet ngritja e serrës;
- Konfiguracioni i terrenit.

Dokumentacioni:

- Numri identifikues i fermerit (NIF);
- Kopja e një dokumenti identifikues valid të Republikës së Kosovës;
- Certifikata mbi pronësinë e paluajtshme, jo më e vjetër se 6 (gjashtë) muaj;
- Kopja e planit të sipërfaqes punuese dhe të parcelës ku planifikohet të ndërtohet serra, jo më e vjetër se 6 muaj;
- Kontrata e shfrytëzimit të tokës;
- Deklarata nën betim.

Data për aplikim prej 04.02.2025 deri më 24.02.2025, aplikimi bëhet në objektet e tri Bashkësive Lokale në: Besi, Llukar dhe Taslixhe.

VËREJTJE

Nëse komisioni parasheh të nevojshme sjelljen e dokumenteve shtesë, të cilat mundësojnë zgjedhjen e përfituesit, aplikuesi (fermeri) është i obliguar t'i sjellë ato në afatin e caktuar, në të kundërtën e humb të drejtën për të qenë përfitues i grantit.